

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Ragip Namani dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Driart Elshani nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr.regj.37299/11, datë 21.06.2012, në bazë të nenit 39,219 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 13.08.2012 merr

## AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

**ABROGOHET** aktvendimi i atakuar dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVAIRE - PUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK / DMP
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages	02
Nr. i reg. Broj reg. Dat.	03-3146/12 10-09-2012

## A r s y e t i m

**Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë**, sipas aktvendimit Nr.regj.37299/11, të datës 21.06.2012, të pandehurin Driart Elshani nga Prishtina, e ka shpallur përgjegjës sepse si drejtor i Departamentit për Qeverisje Elektronike në Ministrinë e Administratës Publike në Prishtinë i zgjedhur në këtë detar më datën 07.06.2011, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë me rastin e marrjes së funksionit pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, edhe pse ka qenë i njoftuar nga zyrtarja e kësaj ministrie për obligimin që del nga Ligji me nr.03/L-152, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 7 parag.1 i sanksionuar me nenin 16 parag.1,2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen e Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, me nr.03/L-151, dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 500.-€ (Pesëqind euro), duke e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5.-€ (pesë euro).

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri ka paraqitur ankesë në të cilën përpos tjerash thekson se asnjëherë nuk ka qenë i informua me obligimin për deklarin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë sepse në detyrën e zyrtarit të lartë (drejtor i departamentit për qeverisje elektronike në Ministrinë e Administratës Publike) është zgjedhur më 07.06.2011 dhe nuk ka qenë i njoftuar por obligimin e lartcekur, se me mosdeklarim me kohë të pasurisë nuk kaq pasur qëllim fshehjen e prejardhje së pasurisë, por kjo ka ndodhur si rezultat i mosinformimit lidhur me këtë obligim. Më tutje thekson se kur është informuar për obligimin e tij për ta plotësuar formularin për deklarin e pasurisë, ky menjëherë ka vepruar ashtu që e ka plotësuar dhe dërguar në AKK më datën 28.10.2011 etj. andaj propozon që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe ky si i pandehur të lirohet nga përgjegjësia dhe gjoba e shqiptuar.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e atakuar, deklarin e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 23.01.2012, nga dëshmia e dëshmitares Bahrije Spanca të dhënë më datë 23.02.2012 si dhe nga procesverbali mbi ballafaqimin në mes të pandehurit Driart Elshani dhe dëshmitares Bahrije Spanca të përpiluar më datë 29.05.2012, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, andaj ankesën e paraqitur e aprovoi si të bazuar, kurse aktvendimin e atakuar e abrogoi dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

2.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të atakuar për shkak të:  
-vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se i pandehuri e mohon ta ketë kryer kundërvajtjen e cila i ngarkohet edhe me rastin e rishqyrtimit të aktvendimit kurse dëshmitarja Bahrije Spanca si në procedurën paraprake ashtu edhe në riprocedurë thekson se e ka njoftuar të pandehurin për deklarimin e pasurisë, por nga kjo deklaratë nuk mund të kuptohet kjartë se kur e ka njoftuar të pandehurin për obligimin e tij për deklarimin e pasurisë me rastin e marrjes së detyrës. Në riprocedurë, me rastin e ballafaqimit në mes të pandehurit dhe dëshmitares, dëshmitarja thekson, pos tjerash, se e ka njoftuar të pandehurin për obligimin që të deklaroj pasurinë, duke shtuar se e ka obliguar që ta nënshkruan **listën mbi pranimin e dokumentacionit**, mirëpo si herën e parë ashtu edhe në riprocedurë nuk ofrohet si dëshmi një listë e tillë e të cilën i pandehuri e mohon.

Gjykata e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë më datën 27.03.2012 ka marr aktvendim mbi abrogimin e aktvendimit të. Datës 24.02.2012 dhe lëndën e kthen gjykatë së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje mu për shkak të mos vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e sidomos për skjarimin e shkresës së Ministrisë së Administratës Publike, zyra e personelit e cila shkresë është dërguar nga zyrtarja e lartë e personelit Bahrije Spanca për zyrtarin e lartë për mbikëqyrjen e pasurisë-AKKK z.Agron Behrami i cili njoftohet se kjo shkresë është një listë e plotësuar në kabinetin e MAP-it. Gjykata e shkallës së parë edhe në këtë rast nuk kërkon nga dëshmitarja listën mbi pranimin e dokumentacionit dhe as nuk skjaron shkresën e theksuar më lartë e cila nuk përmban kurfar date e që është një listë që i dërgohet z.Agron Behramit nga Bahrije Spanca e cila nuk mund të kuptohet si listë për pranimin e dokumentacionit.

Në plotësim procedure gjykata e shkallës së parë duhet të veproj sipas vërejtjeve të theksuara më lartë, të konstatoj dhe dëshmoj se është njoftuar apo jo i pandehuri për obligimin e deklarimit të pasurisë sipas mënyrës së paraparë me ligj e cila parashihet në nen 4 pika 2.2 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë nr.04/L-050 dhe pas konstatimit të plotë të gjendjes faktike të merret aktvendim i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga sa u tha më lartë, konform nenit 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,**  
**GJL.nr.823/12 të datës 13.08.2012.**

SEK. JURIDIKE,  
Zymrije Çunaku



**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
Dalip Bega